



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1378 Prot.

Lezhë, më 28 . 01 . 2021

**VENDIM**

Nr 06 , Datë 27 / 01 / 2021

**“Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Lezhë.”**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.2 gërma a, në ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8 i ndryshuar, në ligjin 8744 date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Seksioni IV, Ligji 111/2018 “Për Kadastrën” Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, Ligji 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 24, Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, në VKM nr 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pjeshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësisë Administrative Blinisht -Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.
  - a. Lista e inventarit bashkëngjitur, Fshati Blinisht, Nj. A. Blinisht, Bashkia Lezhë.
2. Paraqitjen e listës së pjeshme paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

